



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 01/09/2020

- I. Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 31.08.2020, të parashtruar nga Grupi i Operatorëve Ekonomik **SH. Drini Company SH.P.K., & “Berisha Com” sh.p.k.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Mirëmbajtja e autorrugëve” – pj.I-rë: “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane”**, me Nr. 632-19-7809-2-1-1, Nr. Brendshëm 632-18-072-211.

nxjerr:

VENDIM

- II. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Grupit të Operatorëve Ekonomik **SH. Drini Company SH.P.K., & “Berisha Com” sh.p.k.**, e dt. **31.08.2020**, lidhur me aktivitetin e prokurimit **Mirëmbajtja e autorrugëve” – pj.I-rë: “Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane”**, me Nr. 632-19-7809-2-1-1, Nr. Brendshëm 632-18-072-211, kundër Njoftimit **MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te AK –së, të datës 26.08.2020, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** të publikuar me datë: 26.08.2020;

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të ju dorëzohet palëve/

Arsyetim

Meqë Grupi i Operatorëve Ekonomik **SH. Drini Company SH.P.K., & "Berisha Com" sh.p.k.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Mirëmbajtja e autorrugëve" – pj.I-rë: "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve urbane"**, me Nr. **632-19-7809-2-1-1**, Nr. Brendshëm **632-18-072-211**

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 01.09.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pas rishikimit të dokumenteve, autoriteti Kontraktues, konstaton se Grupi i Operatorve Ekonomik **"Company Murseli" sh.p.k. & NTSH "Viktory Com"**, i plotëson të gjitha kushtet e kërkuara në dosjen e tenderit dhe Autoriteti Kontraktues, mbetet pranë vendimit të marrë.

Tenderi juaj është i pasuksesshëm për arsye se ishte me çmim më të lartë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Arkivit të Komunës

